



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 10.05.2023

Nr: 88

Ora: 12:00

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 54, DATË 08.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 10.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë"

**OBJEKT:** Kundërshtimi i vendimit nr. 455, datë 06.05.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 386 nga KRIIK për afishimin e materialeve propagandistike në

kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në aksin rrugor kombëtar Tiranë Lushnjë”.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

#### **VËREN:**

Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 54 regj., datë 08.05.2023. Në mbledhjen e datës 10.05.2023, ora 12:00, pas relatimit të z. Elvin Lako u konstatua se kërkesa ankimore nr. 54 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 54, datë 08.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 11.05.2023, ora 13:30.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

